



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKT –VENDIM

NR.____, DATË __/__/2025

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 6.200.000 (GJASHTË MILION E DYQIND MIJË) LEKË PËR FURNIZIMIN ME ORENDI E PAJISJE TË SHKOLLËS SË MESME TË PËRGJITHSHME MANËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ, SIPAS PROJEKTIT “FV ORENDI E PAJISJE GJIMNAZI MANËZ”.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027” si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 6.200.000 (gjashtë milion e dyqind mijë) lekë për furnizimin me orendi e pajisje të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Manëz, Njësia Administrative Manëz, sipas projektit “FV orendi e pajisje Gjimnazi Manëz”.

2. Ky fond do të merret nga fondi rezervë i Bashkisë Durrës, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtör

Alneida Rroshi

DREJTORIA E ARSIM, KULTURË,
RINI, SPORTE DHE KOM.FETARE

Drejtör

Adrian Gurra

DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtör

Valbona Qiriako

KRYETAR

Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA ARSIM, KULTURËS, RINISË, SPORTEVE DHE KOMUNITETEVE FETARE
SEKTORI I ARSIMIT

RELACION

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 6.200.000 (6 MILION E
DYQIND MIJË) LEKË PËR FURNIZIMIN ME ORENDI E PAJISJE TË SHKOLLËS
SË MESME TË PËRGJITHSHME MANËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ,
SIPAS PROJEKTIT "FV ORENDI E PAJISJE GJIMNAZI MANËZ".**

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Durrës financon në procesin e rindërtimit me fondet e veta ndërtimin e dy objekteve arsimore, përkatësisht, gjimnazin Manëz, Njësia Administrative Manëz dhe shkollën 9 vjeçare Vadardhë, Njësia Administrative Sukth. Gjimnazi Manëz është ndërtim i ri në këtë proces dhe ka momentalisht 180 nxënës dhe 15 mësues nga 250 që e kanë frekuentuar gjithmonë, kjo për shkak të faktit që mësimi zhvillohet mbasdite në shkollën "Xhelal Shtufi" Shkafane, Ishëm. Shkolla e re është projektuar për 324 nxënës, me kushte dhe standarte bashkëkohore. Fillimi i punimeve është bërë në dhjetor të vitit 2024 dhe përfundojnë në prill të vitit 2026.

Kjo shkollë ka një sipërfaqe ndërtimi 3836.8 m² me vlerë 315.162.521 lekë. Shkolla do të jetë 3 kate me 9 klasa mësimore me kapacitet 36 nxënës/klasë, 4 laboratore, IT, biologji, kimi dhe fizikë, një bibliotekë, një auditor, palestër të brendëshme dhe terren sportive jashtë, tarracë dhe zonë recreative sportive.

Duke marrë shkas nga ecuria e punimeve në terren si dhe nga kontaktet me firmën sipërmarrëse është arritur në konkluzionin se punimet do të përfundojnë përpara afatit të kontratës, konkretisht në dhjetor 2025. Bashkia Durrës nisur nga afati i kontratës së punimeve (prill 2026) ka bërë parashikimin e fondit 6.200.000 lekë në draftin e PBA 2026-2028 për të mobiluar objektin për fillimin normal të procesit mësimor.


Për këtë arsye, që shkolla të bëhet funksionale, kërkojmë miratimin e përdorimit të fondit prej 6.200.000 lekë të parashikuar më lart për Projektin "FV orendi e paisje Gjimnazi Manëz". Ky fond do të shërbejë për paisjen e shkollës me orendi e paisje (banka, tavolina, dollape etj.) për të bërë të mundur kthimin sa më shpejt të nxënësve të kësaj shkolle në shkollën e tyre të re.

Fondi do të merret nga fondi rezerve i Bashkisë Durrës i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.115 datë 24.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".

Në përfundim kërkojmë nga ana juaj të miratoni përdorimin e fondit 6.200.000 lekë për orendi e paisje në Gjimnazin Manëz, që shkolla të bëhet funksionale sa më shpejt për të zhvilluar normalisht procesin mësimor në shkollën e re.

Duke ju falenderuar,

Drejtör Arsim, Kulturë, Rini, Sport dhe Komuniteteve Fetare
Adrian Gurra



Drejtore e Buxhetit

Valbona Qirjako